



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kuvendi

PROJEKT LIGJ

NR. ____/2018

PËR

STATUSIN E DËSHMORIT TË ATDHEUT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i kriterëve dhe procedurës për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut” si dhe të drejtat e përfitimet që rrjedhin nga ky status.

**Neni 2
Qëllimi**

Qëllimi i ligjit është shpallja ose njohja e statusit “Dëshmor i Atdheut” për personat, të cilët me akte të rralla patriotizmi, vetëmohimi dhe heroizmi të jashtëzakonshëm kontribuan në luftën për liri, pavarësi dhe çlirim kombëtar të Shqipërisë, deri në dhënien e jetës, si dhe për personat, të cilët kanë dhënë e japin jetën për mbrojtjen e integritetit territorial, të interesave kombëtare shqiptare, në luftën kundër terrorizmit dhe krimit ndaj jetës së individit, mbrojtjen e pronës publike si dhe në raste fatkeqësish natyrore, në ndihmë të popullsisë.

**Neni 3
Subjektet**

Subjekte të këtij ligji janë, të ndjerët, Dëshmorët e Atdheut, familjarët e tyre si dhe organet e pushtetit qendror e të njësive të vetëqeverisjes vendore, që ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj.

Neni 4 Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Person”**, personi fizik me shtetësi shqiptare, shtetasi i huaj ose pa shtetësi si dhe personi fizik që ka jetuar e vepruar përpara datës së krijimit të shtetit shqiptar (28 nëntor 1912);
2. **“Shpallje”**, vendimi i Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, që i jep të ndjerit statusin e “Dëshmorit të Atdheut”;
3. **“Njohje”**, vendimi i Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, që konfirmon të gjitha dekretet dhe vendimet e dhëna nga organet shtetërore për shpalljen “Dëshmor” përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji;
4. **“Familje e Dëshmorit të Atdheut”**, familja që i ka dhënë Shqipërisë një apo më shumë persona të shpallur “Dëshmor i Atdheut”;
5. **“Organe shtetërore të mëparshme”**, ish-organet shtetërore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, si p.sh.: ish-Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit, ish-Këshilli Ekzekutiv Pluralist i Rrethit, Këshilli Bashkiak si dhe Kuvendi Popullor apo Kryesia e Këshillit të Ministrave;
6. **“Subjekte kërkuese”**, përfaqësues të familjes së të ndjerit, për të cilin kërkohet që të shpallet ose të njihet “Dëshmor i Atdheut”, apo përfaqësues të familjes së dëshmorit, drejtues të organeve shtetërore, organizatave të dëshmorëve të atdheut si dhe përfaqësues të shoqërisë civile;
7. **“Organe publike”**, organet përfaqësuese të pushtetit qendror e vendor, institucionet e administratës, qendrore dhe vendore, të pushteteve kushtetuese, personat juridikë e fizikë, në masën që ata përmbushin funksionet publike ose ushtrojnë një detyrë administrative, sipas ligjeve në fuqi.

KREU II KRITERET PËR SHPALLJEN OSE NJOHJEN E STATUSIT “DËSHMOR I ATDHEUT”

Neni 5 Kriteret për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut”

Dëshmorë të Atdheut shpallen ose u njihet statusi, si të tillë,:

- a) personat, të cilët kanë humbur jetën për lirinë, pavarësinë kombëtare dhe mbrojtjen e territoreve shqiptare apo në përpjekje për mësimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe para datës 28 nëntor 1912;
- b) shtetasit shqiptarë e të huaj, të cilët kanë rënë në luftë për mbrojtjen e integritetit territorial, të lirisë e pavarësisë së Shqipërisë, si dhe për arsye të kundërshtimit të pushtimit të trojeve shqiptare nga ushtritë e huaja dhe të qëllimeve shoviniste të tyre, nga data 28 nëntor 1912 deri më 7 prill 1939;
- c) shtetasit shqiptarë, të cilët kanë humbur jetën në mbrojtje të vlerave kombëtare e patriotike të kombit shqiptar para datës 7 prill 1939;
- ç) shtetasit shqiptarë, të cilët kanë marrë pjesë me armë në dorë ose në formë të organizuar në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe kanë rënë duke luftuar kundër pushtuesve nazifashistë e bashkëpunëtorëve të tyre, nga data 7 prill 1939 deri më 9 maj 1945;
- d) shtetasit shqiptarë të pushkatuar për pjesëmarrjen në formacionet luftarake të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare apo për mbështetje të pjesëmarrësve të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar si dhe të pushkatuar për hakmarrje nga pushtuesit nazifashistë apo bashkëpunëtorët e tyre, nga data 7 prill 1939 deri më 9 maj 1945;
- dh) shtetasit shqiptarë, të cilët janë ekzekutuar apo kanë vdekur në burgjet dhe kampet nazifashiste të përqendrimit deri më 9 maj 1945, si dhe shtetasit shqiptarë, të cilët brenda 2 viteve, nga dita e daljes nga burgjet apo kampet nazifashiste të përqendrimit, kanë vdekur si pasojë e plagëve apo sëmundjeve të ndryshme të marra në këto vende;
- e) shtetasit shqiptarë, pjesëtarë të formacioneve ushtarake të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, të cilët kanë rënë në luftën kundër pushtuesve nazifashistë jashtë kufijve shtetërorë deri më 9 maj 1945;
- ë) shtetasit shqiptarë, pjesëmarrës në formacione të rregullta të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, të cilët kanë humbur jetën brenda datës 9 maj 1947 për shkak të sëmundjeve dhe plagëve të marra ose fatkeqësive të ndryshme, duke qenë në krye të detyrës luftarake;
- f) shtetasit shqiptarë që kanë rënë duke luftuar në Spanjë (1936-1939) ose në vende të tjera, të inkuadruar në formacionet e koalicionit antifashist, deri më 9 maj 1945, ose që kanë vdekur brenda 2 vjetëve nga plagët apo sëmundjet e marra në këto luftëra;
- g) shtetasit e huaj, pjesëtarë të formacioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që kanë rënë duke luftuar kundër pushtuesve nazifashistë;
- gj) shtetasit e huaj, pjesëtarë të formacioneve të ushtrive aleate në Luftën e Dytë Botërore, në ndihmë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare, të cilët kanë humbur jetën brenda territorit të Shqipërisë;
- h) shtetasit shqiptarë, të cilët kanë rënë duke luftuar për pavarësinë e Kosovës, si dhe shtetasit shqiptarë të rënë për të drejtat kombëtare në konfliktet e tjera etnike të zhvilluara në Ballkan;
- i) shtetasit shqiptarë që bien në mbrojtje të integritetit territorial të

Republikës së Shqipërisë, mbrojtjen e institucioneve shtetërore nga terrorizmi ose në luftën kundër bandave të armatosura dhe krimit ndaj jetës së individit;

- j) shtetasit shqiptarë, të cilët vriten nga elementë kriminalë për shkak të detyrës shtetërore që kanë kryer, në luftë kundër krimit dhe përpjekjeve për vendosjen e rendit dhe të qetësisë publike;
- k) shtetasit shqiptarë që bien në krye të detyrës, për mbrojtjen e paqes dhe të lirisë së kombit shqiptar, ose ata që bien në krye të detyrës me misione në mbrojtje të paqes e të sigurisë së popujve të tjerë;
- l) shtetasit shqiptarë që humbin jetën në krye të detyrës, për mbrojtjen e pasurisë publike ose nga rreziqet e fatkeqësitë natyrore;
- ll) shtetasit shqiptarë të vrarë gjatë tubimeve paqësore dhe pa armë për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si dhe ata që kanë humbur jetën në krye të detyrës në mbrojtje të procesit zgjedhor, pas datës 8 dhjetor 1990;
- m) shtetasit shqiptarë, të cilët kanë humbur jetën ose që e humbin jetën në përpjekje për të ndihmuar popullsinë në raste fatkeqësish natyrore, në përpjekje për mbrojtjen e pronës publike ose për shpëtimin dhe mbrojtjen e jetës së individit nga krimi;
- n) shtetasit shqiptarë që vriten nga forcat apo elementët antishqiptarë në mbrojtje të flamurit, simboleve kombëtare dhe manifestimit të ndjenjave kombëtare;
- nj) shtetasit e huaj, pjesëtarë të formacioneve në ndihmë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë apo Policisë së Shtetit Shqiptar, të cilët humbin jetën në krye të detyrës, në ndihmë të popullsisë apo në përpjekje kundër terrorizmit ose krimit ndaj jetës së individit;
- o) shtetasit e huaj, pjesëtarë të formacioneve ushtarake të NATO-s, në ndihmë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që humbin jetën në krye të detyrës, në mbrojtje të integritetit territorial të Republikës së Shqipërisë;
- p) ekuipazhet, të cilët bien në krye të detyrës shtetërore gjatë fluturimit.

Neni 6

Përfashtimi nga statusi “Dëshmor i Atdheut”

Statusin “Dëshmor i Atdheut” nuk e përfitojnë personat, të cilët janë dënuar me vendime gjykatë të formës së prerë për:

1. krime kundër njerëzimit;
2. bashkëpunim me pushtuesit e vendit;
3. veprimtari terroriste dhe agjenturore kundër interesave të Shqipërisë;
4. vrasje me dashje, pas datës 9 maj 1945.

Neni 7

Dëshmorët e shpallur me vendime të organeve shtetërore të mëparshme

Të gjitha dekretet/vendimet e organeve shtetërore për shpalljen “Dëshmor”, të marra para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk janë objekt rishikimi nga ky ligj.

Neni 8

Dokumentet për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut”

1. Për shpalljen “Dëshmor i Atdheut” vlejné si burime parësore dokumente të organeve publike, të krijuara në kohën e ngjarjes dhe, si burime dytësore, botimet me karakter historik, folklorik, publicistik e manuale biografike, të cilat shprehen për ngjarjen.
2. Për njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut” vlejné dekretet/vendimet e organeve shtetërore të mëparshme për shpalljen “Dëshmor”, si dhe, në mungesë të tyre, vetëm burimet parësore, sipas pikës 1, të këtij neni.
3. Llojet e dokumenteve, që paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut”, si dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre përcaktohen me udhëzim të kryetarit të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

Neni 9

Kërkesa për shpalljen “Dëshmor i Atdheut” dhe njohjen e statusit

1. Kërkesën për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut” e bën përfaqësuesi i autorizuar i familjes së të ndjerit, organet shtetërore ose përfaqësues të shoqërisë civile.
2. Forma e përmbajtjes së kërkesës përcaktohet në udhëzimin e kryetarit të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, të përcaktuar në pikën 3, të nenit 8.

KREU III

ORGANET E PARAQITJES SË KËRKESËS, TË PROPOZIMIT DHE MARRJES SË VENDIMIT

Neni 10

Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmori i Atdheut”

1. Pranë Ministrisë së Mbrojtjes krijohet Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmori i Atdheut”, i cili është autoriteti që jep ose njeh statusin “Dëshmor i Atdheut” sipas propozimit të bërë nga këshilli i qarkut, këshilli bashkiak, prefekti ose ministri përkatës, për subjektet nën fushën e tyre të përgjegjësisë së tij.
2. Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” është organ kolegjal dhe i përhershëm, i cili përbëhet nga 7 anëtarë. Komisioni kryesohet nga

ministri i Mbrojtjes dhe në përbërje ka 4 anëtarë në rang zëvendësministrash dhe 2 anëtarë nga shoqëria civile.

3. Përbërja dhe rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Qendror përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes.
4. Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut”, për ushtrimin e përgjegjësi të caktuara në ligj, mbështetet nga një staf teknik. Përgjegjësi i stafit teknik kryen dhe detyrën e sekretarit teknik të komisionit Qendror.
5. Anëtarët e Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut” marrin shpërblim financiar për pjesëmarrjen në mbledhjen e Komisionit Qendror sipas legjislacionit në fuqi. Këshilli i Ministrave cakton masën e shpërblimit si dhe institucionin që kryen pagesën.
6. Propozimet e dërguara nga këshillat e qarqeve, këshillat bashkiakë apo prefektët shqyrtohen nga Komisioni Qendror, brenda 3 muajve, nga afati i regjistrimit në sekretarinë e Komisionit Qendror.
7. Komisioni Qendror raporton para Këshillit të Ministrave, të paktën 1 herë në vit, për punën e bërë për statusin e “Dëshmorit të Atdheut”.

Neni 11

Komisionet vendore

1. Pranë këshillave të qarqeve, bashkive dhe pranë prefekturave ngrihen dhe funksionojnë komisione për shqyrtimin e kërkesave për dhënien ose njohjen e statusit të “Dëshmorit të Atdheut”.
2. Kërkesa për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut”, së bashku me dokumentet shoqëruese, i paraqiten komisionit për shqyrtimin e kërkesave pranë këshillit të qarkut, këshillit bashkiak ose prefektit, ku ka vendbanimin familja e të ndjerit që kërkohet të shpallet ose të njihet si “Dëshmor i Atdheut”.
3. Komisionet, brenda 1 muaji, nga depozitimi i kërkesës, shqyrtojnë kërkesat dhe dokumentet shoqëruese, të cilat relatohen, përkatësisht, në këshillin e qarkut, këshillin bashkiak ose te prefekti, për të vendosur lidhur me kërkesën e bërë.
4. Këshilli i qarkut, këshilli bashkiak ose prefekti merr vendim brenda 1 muaji, nga relatimi nga komisioni përkatës, për dërgimin ose jo të propozimit për trajtim pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

5. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të komisioneve për shqyrtimin e kërkesave për dhënie ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut” miratohen sipas përkatësisë, me vendim të këshillit të qarkut, këshillit bashkiak ose prefektit.

Neni 12

Ministri

Në rastet e të rënëve sipas shkronjave “gj”, “h”, “i” e “j”; “l”; dhe “nj”, “o”, e “p”, të nenit 5, të këtij ligji, ministri, brenda fushës së përgjegjësisë të të cilit është i rëni, mund t’i propozojë drejtpërsëdrejti Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut” shpalljen e të ndjerit “Dëshmor i Atdheut”.

KREU IV

VARREZAT E DËSHMORËVE DHE CEREMONITË NË NDERIM TË TYRE

Neni 13

Vendprehja e Dëshmorëve të Atdheut

1. Në shenjë nderimi, përkujtimi dhe mirënjohjeje kombëtare për Dëshmorët e Atdheut janë ndërtuar dhe do të ndërtohen varrezat ku prehen Dëshmorët e Atdheut.
2. Ndërtimi, mirëmbajtja dhe ruajtja e Varrezave të Dëshmorëve të Atdheut bëhet nga shteti, sipas rregullave e procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Çdo dëshmor ka një varr në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut, të ngritur në territorin e qarkut ku ka rënë ose ka pasur vendbanimin, me përjashtim të atyre që prehen në Varrezën e Dëshmorëve të Atdheut “Nëna Shqipëri”, në kryeqytet.
4. Varrimi i Dëshmorit të Atdheut apo rivarrimi i mbetjeve mortore të tij në Varrezën e Dëshmorëve të Atdheut “Nëna Shqipëri”, në kryeqytet, bëhet me vendim të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, me kërkesë të këshillit bashkiak, këshillit të qarkut, prefektit ose ministrit.
5. Varrimi i Dëshmorit të Atdheut apo rivarrimi i mbetjeve mortore të tij në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut në qarqet përkatëse bëhet me vendim të këshillit të qarkut, këshillit bashkiak ose të prefektit.
6. Për Dëshmorët e Atdheut, të cilëve nuk u janë gjetur eshtrat, në brendësi të territorit të Varrezave të Dëshmorëve të Atdheut mund të vendosen ndërtime monumentale apo pllaka përkujtimore me emrat dhe të dhënat e tyre.

7. Në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut, në shenjë nderimi, qëndron gjithmonë i ngritur flamuri kombëtar.
8. Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut mbajnë statusin e varrezave monumentale dhe të veprave kulturore.
9. Në vendvarrimet e Dëshmorëve të Atdheut zhvillohen ceremoni zyrtare dhe homazhe.

Neni 14

Ceremonia e varrimit të Dëshmorit të Atdheut

Varrimi i Dëshmorit të Atdheut apo rivarrimi i mbetjeve mortore të tij bëhet me ceremoni zyrtare, me arkivol të mbuluar me flamurin kombëtar.

Neni 15

Objektet në nderim të Dëshmorëve të Atdheut

1. Në shenjë nderimi për Dëshmorët e Atdheut, me vendim të këshillit të qarkut/këshillit bashkiak/prefektit ose me urdhër të ministrit, brenda territoreve nën juridiksionin e tyre ngrihen, mirëmbahen dhe ruhen lapidare, pllaka përkujtimore, përmendore si dhe emërtohen mjedise e institucione publike.
2. Zhvendosja e përmendoreve, lapidarëve, pllakave përkujtimore si dhe e objekteve të tjera, që kanë lidhje me Dëshmorët e Atdheut, bëhet vetëm në raste të veçanta, kur këtë e kërkojnë interesa të lartë shtetërorë dhe me vendim/urdhër të autoritetit që i ka ngritur ato.
3. Zhvendosja e përmendoreve, lapidarëve, pllakave përkujtimore si dhe e objekteve të tjera, që kanë lidhje me Dëshmorët e Atdheut, të ngritura nga organe shtetërore, të cilat nuk ekzistojnë më, bëhet me vendim të këshillit bashkiak, nën juridiksionin territorial të të cilit ndodhen këto objekte, ose me urdhër të ministrit, në rastet kur këto objekte ndodhen në pronat e paluajtshme në përgjegjësi administrimi të ministrisë përkatëse.

Neni 16

Dita përkujtimore e Dëshmorëve të Atdheut

Dita përkujtimore e Dëshmorëve të Atdheut është 5 maji.

Neni 17

Organizimi i ceremonive përkujtimore

Organet e pushtetit qendror e vendor, shoqëria civile si dhe organizatat e Dëshmorëve të Atdheut organizojnë dhe marrin pjesë në ceremonitë përkujtimore për Dëshmorët e Atdheut me rastin e 5 majit dhe 28 e 29 nëntorit.

KREU V
FAMILJET E DËSHMORËVE DHE SIMBOLET NË NDERIM
TË TYRE

Neni 18
Familja e Dëshmorit të Atdheut

1. Familjet e Dëshmorëve të Atdheut gëzojnë nderim e përkrahje të veçantë nga shteti. Ato përfitojnë shpërblim financiar mujor, kriteret dhe masa e të cilit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Mbrojtjes.
2. Në rrethin e familjarëve, për efekt shpërblimi, bëjnë pjesë bashkëshorti/ bashkëshortja, fëmijët nën moshën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur kryejnë studimet e larta, prindërit bashkëjetues dhe personat në kujdestari, sipas certifikatës së gjendjes familjare në çastin e vdekjes së Dëshmorit të Atdheut.
3. Shpërblimi ndërpritet kur asnjëri nga familjarët nuk plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, dhe kur bashkëshortja/bashkëshorti i Dëshmorit të Atdheut martohet përsëri.
4. Shpërblimi familjar tërhiqet nga kryefamiljari i Dëshmorit të Atdheut ose, në rast mosmarrëveshjeje, kur është më shumë se një person, nga secili, sipas pjesës që i përket.
5. Në familjen e Dëshmorit të Atdheut, për efekt nderimi dhe mirënjohjeje, përfshihen bashkëshorti/bashkëshortja, bashkëjetuesi/bashkëjetuesja, fëmijët, prindërit, vëllezërit dhe motrat, prindërit e prindërve, njerka, njerku, thjeshtri, thjeshtra, mbesat dhe nipërit e dëshmorit.

Neni 19
Simbolet e statusit “Dëshmor i Atdheut”

1. Familja e Dëshmorit të Atdheut pajiset nga Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” me certifikatën e Dëshmorit të Atdheut dhe simbolin “Familje e Dëshmorit të Atdheut”, me ceremoni zyrtare, që zhvillohen për këtë rast.
2. Procedura e organizimit të ceremonisë së dorëzimit të certifikatës dhe simboleve të Dëshmorit të Atdheut si dhe forma dhe përmbajtja e tyre përcaktohen me vendim të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

KREU VI
SHOQATA E FAMILJEVE TË DËSHMORËVE TË ATDHEUT

Neni 20

Organizatat e Dëshmorëve të Atdheut

Në nderim të Dëshmorëve të Atdheut dhe të promovimit të veprës së tyre mund të krijohen organizata jofitimprurëse (shoqata, fondacione, qendra), veprimtaria e të cilave zhvillohet në mënyrë të pavarur nga organet shtetërore, që veprojnë e përmbushin detyrimet sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.8788, datë 7.5.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar.

Neni 21

Organizimi i familjeve të dëshmorëve

1. Familjet e Dëshmorëve të Atdheut mund të organizohen në organizatat e tyre.
2. Familja e Dëshmorit të Atdheut dhe organizata e tyre kanë të drejtë të kërkojnë nga organet e njëjse të vetëqeverisjes vendore e qendrore marrjen e masave për mirëmbajtjen e varrezave të Dëshmorëve të Atdheut, të lapidarëve, busteve, pllakave përkujtimore si dhe çdo kërkesë tjetër të ligjshme në lidhje me “Dëshmorët e Atdheut”.

Neni 22

Marrëdhëniet e organizatave me organet shtetërore

1. Shteti mbështet dhe nxit veprimtaritë e organizatave që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre Dëshmorët e Atdheut.
2. Organet e qeverisjes qendrore dhe vendore bashkëpunojnë me organizatat e familjeve të Dëshmorëve të Atdheut për organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve në kuadër të festave kombëtare e vendore si dhe të aktiviteteve që organizohen në kujtim të veprës së Dëshmorëve të Atdheut.

KREU VII

E DREJTA E ANKIMIT

Neni 23

Ankimi

1. Subjektet e interesuara, kundër vendimit të këshillit bashkiak, këshillit të qarkut apo prefektit, që refuzon të pranojë kërkesën ose kur këto organe nuk marrin në shqyrtim kërkesën brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, mund të paraqesin ankim pranë gjykatës administrative të shkallës së parë sipas juridiksionit territorial.

2. Subjektet e interesuara, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut” si dhe në rastet kur ky komision nuk shprehet brenda afateve ligjore të përcaktuar në pikën 7, të nenit 10, të këtij ligji, kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 24

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që, brenda 1 viti, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatimin të neneve 10, pikat 3 e 5, 13, pika 2, dhe 18, pika 1, të këtij ligji.
2. Ngarkohen këshillat e qarqeve, këshillat bashkiakë dhe prefektët, që, brenda 1 viti, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin vendimet përkatëse, në zbatim të pikës 5, të nenit 11, të këtij ligji.
3. Ngarkohet kryetari i Komisioni Qendror të Statusit “Dëshmori i Atdheut”, që, brenda 1 viti, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzim në zbatim të pikës 3, të nenit 8, të këtij ligji.
4. Ngarkohet Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmori i Atdheut”, që, brenda 1 viti, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë vendim në zbatim të pikës 2, të nenit 19, të këtij ligji.
5. Aktet nënligjore, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien në kundërshtim me të, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 25

Shfuqizime

Ligji nr.8607, datë 27.4.2000, “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI